



01/Nr. 8383/2020

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11 , 40, Ligji për Arsimin në komunat e Republikës së Kosovës neni 5 paragrafi (d), Udhëzimin Administrativ nr.15/2019 për Detyrat, Përgjegjësitë Procedurat dhe Kriteret e Zgjedhjes së Drejtorit dhe Zëvendësdrejtorit të Institucionit Publik Edukativo Arsimor dhe Aftësues Parauniversitar, neni 5 paragrafi (1) nënparagrafi (1.1) , Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur me datë 26. 11. 2020 merr:

VENDIM
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËRZGJEDHËS

1. Kuvendi i komunës miratoi vendimin për formimin e komisionit përzgjedhës për pozitën drejtor /esh të Institucionit Parashkollorë në Han të Elezit.
2. Duke iu referuar nenit (1) të këtij vendimi, komisioni do të ketë këtë përbërje:
 - Sear Dernjani, (nga DKA) kryesues i komisionit,
 - Vlora Suma, (nga këshilli i prindërve), anëtare dhe
 - Sahit Berisha (nga MASHT-i) anëtar.
3. Komisioni përzgjedhës do të veproj sipas udhëzimeve të parashikuara në Udhëzimin Administrativ nr.15/2019 për detyrat, përgjegjësitë procedurat dhe kriteret e zgjedhjes së drejtorit dhe zëvendësdrejtorit të institucionit publik edukativo arsimor dhe aftësues parauniversitar.
4. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas protokollimit të autoritetit mbikëqyrës dhe 7 ditë pas publikimit në ueb – faqen zyrtare të komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

- Kryetari i Komunës,
- Anëtarët e Komisionit
- Ministria e Pushtetit Lokal dhe
- Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit
Data: 26.11.2020

Kryesuesi i Kuvendit
MSc. Qamush Brava





Republika e Kosovës / Republic of Kosovo
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr. 8705/2020

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11, 12, 40, Ligji Nr. 07/L-001 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020, neni 3, paragrafi 1.43, neni 15 paragrafi 6, Ligji Nr. 07/L-014 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit me nr. 07/L-001 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020, Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, neni 30, paragrafi 30.2, Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit të mbajtur me datën 26.11.2020 merr:

VENDIM
PËR TRANSFER TË MJETEVE NË KATEGORINË EKONOMIKE PAGA DHE SHTESA

1. Kuvendi i komunës miratoi vendimin për transfer të mjeteve në kategorinë ekonomike paga dhe shtesa për vitin 2020.
2. Transferi i mjeteve në total është në shumë prej 38,119.00 € nga fondi 10, në kategorinë ekonomike paga dhe shtesa sipas tabelës 1 të bashkangjitur këtij vendimi.
3. Këto mjete do të shfrytëzohen për pagesën e shujtave, udhëtimeve dhe mësimin të kombinuar për personelin arsimor për vitin 2017, obligime që dalin nga Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë me nr.2056 të datës 18.04.2017.
4. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas protokollimit të autoritetit mbikëqyrës dhe 7 ditë pas publikimit në ueb – faqen zyrtare të komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

- Kryetari i Komunës,
- Drejtorët e Drejtorive,
- Ministria e Financave - Departamenti i Buxhetit,
- Ministria e Pushtetit Lokal dhe
- Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit
Data: 26.11.2020

Kryesuesi i Kuvendit
MSc. Qamush Brava



Tab.1 Transferi i mjeteve në kategorinë ekonomike paga dhe shtesa, për vitin 2020

Programet/nën-programet Buxhetore	Kodi i nën-prog.	Kategoria ekonomike	Fondi	Zvogëlimi i mjeteve	Rritja e mjeteve
Zyra e kryetarit	16035	11 Paga dhe shtesa	10	(698.00)	-
Administrata dhe personeli	16335	11 Paga dhe shtesa	10		1,366.00
Zyra e kuvendit komunal	16935	11 Paga dhe shtesa	10	(1,975.00)	-
Buxhet dhe financa	17535	11 Paga dhe shtesa	10	(3,613.00)	-
Shërbimet Publike, mbrojtja civile dhe emergjenca	18444	11 Paga dhe shtesa	10	(364.00)	-
Zyra komunale për komunitete dhe kthim	19675	11 Paga dhe shtesa	10	(217.00)	-
Bujqësia, pylltaria dhe zhvillimi rural	47115	11 Paga dhe shtesa	10	(1,355.00)	-
Zhvillimi ekonomik	48035	11 Paga dhe shtesa	10	(100.00)	-
Planifikimi urban dhe mjedisi	66480	11 Paga dhe shtesa	10	(5,117.00)	-
Administrata e shëndetësisë	73044	11 Paga dhe shtesa	10	-	100.00
Shërbimet sociale dhe rezidenciale	75671	11 Paga dhe shtesa	10	(3,196.00)	-
Administrata e arsimit	92175	11 Paga dhe shtesa	10	(1,177.00)	-
Arsimi parashkollor dhe çerdhet	92890	11 Paga dhe shtesa	10	(4,497.00)	-
Arsimi fillor	94020	11 Paga dhe shtesa	10	-	36,653.00
Arsimi i mesëm	95220	11 Paga dhe shtesa	10	(15,810.00)	-
Totali				(38,119.00)	38,119.00

Hani i Elezit
Data: 26.11.2020





Republika e Kosovës / Republic of Kosovo
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr. 8736/2020

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11, 51.1, 53, Udhëzimi Administrativ Nr.03/2014 për Procedurën e Themelimit, Përbërjen dhe Kompetencat e Komiteteve të Përhershme në Komunë neni 4, Statuti i Komunës neni 38, Rregulloren e Punës së Kuvendit neni 45, Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur me datë 26.11.2020 merr:

V E N D I M
PËR PLOTËSIMIN E KOMITETIT PËR KOMUNITETE

1. Kuvendi i Komunës miratoi vendimin për plotësimin e Komitetit për Komunitete si komitet obligativ në komunën e Hanit të Elezit.
2. Komitetit për Komunitete përbehet prej 5 anëtarëve dhe i njëjti do të ketë këtë përbërje:
 1. Samire Curri -LDK
 2. Florim Shkreta - PDK
 3. Akif Shkreta - VV
 4. Hyrijete Isufi – Anëtare e Jashtme
 5. Agon Dernjani –Anëtarë i Jashtëm
3. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas protokollimit të autoritetit mbikëqyrës dhe 7 ditë pas publikimit në ueb – faqen zyrtare të komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

- Kryetari i Komunës,
- Anëtarët e Komitetit,
- Drejtoria për Buxhet dhe Financa,
- Ministria e Pushtetit Lokal dhe
- Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit
Data: 26.11.2020

